



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA POGRADEC



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI

Nr. 799 Prot, datë 09. 11.2012

Nr. 412 Prot, datë 10. 10.2012

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DHE
BASHKISË POGRADEC**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkia Pogradec (në vijim të quajtura "Palët")

Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;

Duke u angazhuar për marrjen përsipër për sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;

Duke konsideruarsi domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë;

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

Duke u mbështetur në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" dhe në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim "Memorandumi").

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është, bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkisë Pogradec, me qëllim ndjekjen, kujdesjen, garantimin, ofrimin e shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit, për marrjen pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në funksion të respektimit dhe zbatimit të Kushtetutës , ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" dhe legjisllacionit në fuqi.

Neni 2

Forma e bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:

1. Krijimit dhe funksionimit të një pike kontakti pranë Bashkisë Pogradec për çështjet e diskriminimit;
2. Nxitjes dhe marrjes së masave mbi sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për çështjet e mosdiskriminimit, për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme;
3. Garantimit sipas legjislacionit në fuqi, për ofrimin e shërbimeve që lidhen me pushtetin vendor, për çështjet e diskriminimit;
4. Nxitjes e kujdesjes për realizimin e bashkërendimit të veprimtarisë së pushtetit vendor në drejtim hartimit dhe zbatimit të masave e politikave të posaçme për mbështetjen e integrimin e personave që i përkasin grupeve vulnerabël;
5. Bashkërendimit në dhënien e informacionit lidhur me ankesat e paraqitura nga subjektet e ligjit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, apo përcjelljen për shqyrtim të Komisioneri të informacioneve për raste të identifikuar si diskriminuese nga struktura të Bashkisë Pogradec, si dhe për çdo çështje që lidhet me diskriminimin;
6. Bashkërendimit nëpërmjet ofrimit të dhënies së asistencës ligjore në funksion në funksion të parandalimit dhe eliminimit të akteve dhe praktikave diskriminuese në veprimtarinë dhe shërbimet e ofruara nga pushteti vendor;
7. Ndjekjes dhe bashkërendimit të marrëdhënieve me grupet e ndryshme sociale dhe shoqërinë civile, në funksion të zhvillimit të një dialogu të rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit;
8. Mbështetjes për përgatitjen profesionale, nëpërmjet trainimeve, aftësimin e specializimit të punonjësve të administratës së Bashkisë Pogradec për çështjet e diskriminimi;
9. Marrjes së masave për evidentimin dhe parandalimin e diskriminimit apo çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin edhe në strukturat e Bashkisë Pogradec;
10. Shkëmbimin e përbashkët të statistikave që kanë për bazë numrin e rasteve të raportuara për çështjet e diskriminimit edhe pranë strukturave të Bashkisë Pogradec, apo të statistikave të tjera që kanë lidhje me diskriminimin, me qëllim analizimin e tyre për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e mbrojtjes në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe garantimin e barazisë para ligjit;
11. Bashkëpunimit edhe nëpërmjet formave të tjera për të cilat palët mund të bien dakort në të ardhmen.

Neni 3

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për realizimin e zbatimin e këtij memorandumi.
2. Palët vendosin me vullnetin dhe dëshirën e tyre që mënyra e shkëmbimit të informacionit reciprok të punëve midis tyre, të jetë në formë shkresore, me përjashtim të rasteve urgjente ku forma e koordinimit të punëve dhe shkëmbimit të informacionit realizohet nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar.

Neni 4

Caktimi i personit të kontaktit

1. Palët caktojnë një person kontakti që është përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe të kërkesave të palëve në zbatim të memorandumit.
2. Personi i kontaktit sipas pikës 1 të këtij neni, do të luaj për Bashkinë Pogradecedhe rolin e pikës së kontaktit në nivel lokal për çështjet e mosdiskriminimit.
3. Personat e kontaktit janë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me palën tjetër me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 5

Ndryshimi i Memorandumit

1. Ndryshimet në këtë memorandum bëhen me dëshirën e vullnetin e palëve.
2. Mënyra e paraqitjes së propozimeve për ndryshime në përmbajtjen e këtij memorandumi realizohet me shkrim në rrugë zyrtare, me anë të së cilit përcaktohet edhe afati kohor i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara të secilës palë.
3. Në rast mosmarrëveshesh ose keqkuptimesh në zbatimin e këtij memorandumi, ndryshimi i tij realizohet vetëm nëpërmjet konsensusit dhe mirëkuptimit të palëve.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 7

Përfundimi i Memorandumit

1. Memorandumi lidhet pa afat, por mund të përfundojë në çdo kohë.
2. Duke u bazuar në rregullin e caktuar në pikën 1 të këtij neni, palët detyrohen midis tyre të njoftojnë me shkrim në rrugë zyrtare për përfundimin e këtij memorandumi. Përfundimi hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

1. Memorandumi përgatitet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe 2 (dy) të tjera në Bashkinë Pogradec.
2. Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të palëve.

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet sot më datë 18 / 10 /2012.

KRYETAR I BASHKISË POGRADEC

ARTAN SHKEMBI
(nënshkrimi)



**KOMISIONERI PËR
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

IRMA BARAKU
(nënshkrimi)

